



**UNIVERSITY OF PRISHTINA
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITETI I PRISHTINËS**

Str. 'Xhorxh Bush', Rectorate Building, 10 000 Prishtinë, Republic of Kosovo
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Ref. no.: 2/899

Date: 11/10/2017

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, "Hasan Prishtina" në mbledhjen e mbajtur më 5.10.2017, mbështetur në Ligjin Nr.04/L-o54 dhe Ligjin Nr. 04/ L – 261 mori:

VENDIM

Neni 1

Lirohen me automatizëm nga pagesa e semestrave studentët që i takojnë kategorive sin ë vijim:

- a) Studentët e tri niveleve të studimeve që janë anëtarë të ngushtë të familjeve të dëshmorëve, të zhdukurve dhe invalidëve të luftës së UÇK së (ushtarak apo civilë) (neni 6, paragr. 8 Ligji Nr.04/L-o54).
- b) Studentët e tri niveleve të studimeve – Veteranët luftëtarë dhe fëmijët e tyre (neni 31 Ligji Nr. 04/ L – 261).
- c) Studentët e tri niveleve të studimeve që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës-familjar të viktimave civile të luftës 1.1.1998 – 12.6.1999),
- d) Studentët me nevoja të veçanta në tri nivelet e studimeve,
- e) Studentët e nivelit bachelor dhe master, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale.

Neni 2

Kategoria e studentëve si në paragrafin a), b) dhe c) të nenit 1 të këtij vendimi, me rastin e rigjistrimit të semestrave të vitit akademik, duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- a) vërtetimin e noterizuar (me vulë origjinale të noterit) të lëshuar nga Komisioni qendror për njohjen e statusit të kategorive që kanë dalë nga lufta, dhe
- b) Certifikatën e bashkësisë familjare.

Neni 3

Kategoria e studentëve si në paragrafin d) dhe e) të nenit 1 të këtij vendimi, me rastin e rigjistrimit të semestrave të vitit akademik duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- a) vërtetimin e noterizuar (me vulë origjinale të noterit) të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe
- b) Certifikatën e bashkësisë familjare.

Neni 4


1. Shërbimi i studentëve në fakultet, obligohet që t'ua regjistroi pa pagesë semestrin përkatës të vitit akademik të gjithë studentëve të cilët i takojnë kategorive të sipërshënuara dhe të cilët i plotësojnë kushtet e specifikuar në këtë vendim.
2. Asnjë student që i takon kategorive të sipërshënuara nuk mund të lirohet nga pagesa në qoftë se nuk i ka dokumentet e kompletuara dhe në përputhje me këtë vendim.

Neni 5

Ky vendim duke hynë në fuqi menjëherë dhe do të vlejë deri në nxjerrjen e ndonjë vendimi tjetër.

Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Dekanëve të njësive akademike,
3. Sekretarëve të njësive akademike,
4. Sekretarit të Përgjithshëm të UP-së, dhe
5. Zyrtarit ligjor të KD-së.



Prof. dr. Ismet Salihu

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UP-së